



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0826
Data e Vendimit: 30.09.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik “Arbër Blakaj” B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT” me numër të prokurimit 616-25-6970-5-1-1, iniciuar nga “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”, në cilësinë e autoritetit kontraktues, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 29.09.2025, mori këtë:

Vendim

I.Hedhet si e palejuar(parakohshme) ankesa e “Arbër Blakaj” B.I. me nr. të protokollit 2025/0826 e datës 29.08.2025, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT” me numër të prokurimit 616-25-6970-5-1-1, iniciuar nga “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS” nga cilësia e tij/saj si autoriteti kontraktues (AK).

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT” numër të prokurimit 616-25-6970-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 29.08.20025 ka pranuar ankesën me nr.0826/2025 nga OE “Arbër Blakaj” B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT” me numër të prokurimit 616-25-6970-5-1-1,

inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT” me numër të prokurimit: 616-25-6970-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”, me datë 30.07.2025 ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë të AK afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë data 29.08.2025. Ndërsa OE ankues “Arbër Blakaj” B.I. nuk ka paraqitur kërkesë për Rishqyrtim kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Mirëpo me datën 29.08.2025 OE ankues “Arbër Blakaj” B.I. ka parashtruar ankesë në OSHP me nr.2025/0826.

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së pas pranimin të vendimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, brenda afateve ligjore të parashtrorjës kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund të drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 1 i LPP-së përcakton se: “Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.” Ndërsa neni 109 i LPP-së përcakton se: “Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrorjë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji lidhur me nenin 59 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj si e tillë hedhet si e pa lejuar në kuptimin si e parakohshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

AK “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT” me numër të prokurimit 616-25-6970-5-1-1, megjithatë OSHP i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK ,duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit të, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Arbër Blakaj B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: